



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
APELIT TIRANË MBI ECURINË E PUNËS
NË PROKURORI
PER VITIN 2018**

Shkurt 2019

Analizë vjetore mbi punën e Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2018

Të nderuar kolegë,

Analiza e punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2018, të cilën e zhvillojmë sot, pasqyron në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës tonë, nën dritën e ndryshimeve thelbësore, që kanë shoqëruar sistemin e drejtësisë në vendin tonë. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe paketa ligjore, për reformimin e sistemit të drejtësisë kanë në fokusin e tyre, angazhimin maksimal të të gjithë faktorëve dhe aktorëve në vend, por mbi të gjitha angazhimin e drejtëpërdrejtë të trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të rikthyer besimin e publikut te drejtësia, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Arritjet dhe problematikat e konstatuara gjatë punës sonë, pasqyrojnë sfidat me të cilat jemi përballur. Gjatë vitit që kemi lënë pas, trupa e prokurorëve ka treguar përkushtim profesional dhe eficensë të plotë në përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për nga numri dhe rëndësia e çështjeve që trajtojmë, ne mbetemi një hallkë e rëndësishme, pasi shqyrtojmë numrin më të madh të çështjeve në shkallë vendi, që gjykohen në shkallë të dytë.

Organizimi i punës, nën dritën e refomimit të sistemit të drejtësisë, ka qenë një ndër sfidat kryesore. Nga ana ime si drejtues, janë marrë të gjitha masat, që shpërndarja e punës të bëhet në këtë frymë dhe, në funksion të përfaqësimit dinjitoz në gjyq. Kështu, për masat e sigurimit është përdorur sistemi i prokurorëve të gatshëm, me grafik mujor, duke ruajtur sistemin e radhës. Për çështjet e themelit, është bërë ndarja e çështjeve, në bazë të shortit manual. Është treguar kujdes që

ngarkesa ndërmjet prokurorëve të jetë e barabartë, jo vetëm duke u nisur nga numri, por edhe nga shkalla e rrezikshmërisë dhe e rëndësisë së çështjes, numrit të pandehurve, ndarje në mënyrë të barabartë të çështjeve që gjykohen në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve dhe ankimeve të bëra nga ana e të pandehurve.

Me qëllim që puna jonë të jetë e pasqyruar, transparente dhe e kontrollueshme në çdo kohë, ne vazhdojmë praktikën e paraqitjes në gjykatë të konkluzioneve tona me shkrim, në funksion të qëndrimeve ligjore të unifikuara gjatë gjykimeve. Po kështu, për çdo çështje masë sigurimi, themeli, etj, nga ana jonë mbahet në arshivë një minidosje, e cila përmban aktet kryesore të çështjes së gjykuar.

Nga ana e prokurorëve të apelit janë respektuar afatet ligjore të gjykimit të çështjeve në shkallë të dytë. Në bashkëpunim me Gjykatën e Apelit i është dhënë prioritet çështjeve me të pandehur të arrestuar dhe prokurorët nuk janë bërë shkak për shtyrje të seancave dhe kalim të afateve të paraburgimit për të arrestuarit.

Në punën tonë janë respektuar Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, për pjesën që ka lidhje me gjykimin në Apel. Nga ana jonë janë marrë masa për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, në lidhje me luftën kundër kriminalitetit. Bashkëpunimi i institucionit tonë me të gjithë organet ligjzbatuese ka qenë korrekt dhe në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu është mundësuar pjesëmarrja në konferencat dhe seminarët ku prokurorët e apelit kanë qenë të ftuar.

Në funksion të përmbushjes së detyrave dhe veprimtarisë së punës së prokurorëve, ka asistuar administrata, e cila ka krijuar infrastrukturën e nevojshme teknike, brenda kompetencave dhe detyrimeve ligjore të secilit punonjës.

Në lidhje me sektorin e financës për vitin 2018, kemi punuar për uljen në maksimum të shpenzimeve buxhetore, pa cenuar përmbushjen e nevojave të

domosdoshme. Sektori i financës ka realizuar veprimtarinë e saj, duke zbatuar me korrektësi legjislacionin në fuqi.

Në këtë raport, më lejoni të parashtrij disa aspekte ligjore të punës, të evidentuara përgjatë vitit 2018.

Nga prokurorët është synuar në zbatimin e ligjit penal dhe atij procedural penal me objektivitet. Është respektuar parimi i pavarësisë së prokurorëve Kemi mbështetur në masë apelet e Prokurorëve të Shkallës së Parë, kur kanë qenë të bazuara në shkaqe ligjore.

Por, gjykojmë, se analiza konkrete e treguesve të punës për vitin 2018, bazuar në të dhënat tona, do të nxjerrë në pah më mirë rezultatet e punës tonë. Kështu, në Prokurorinë Apelit Tiranë, gjatë vitit 2018, është përballuar një volum pune i madh për çështje themeli e masa sigurimi, megjithë pakësimin e numrit të prokurorëve.

Prokuroria e Apelit Tiranë ka përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, **2155 çështje penale në themel, me 2520 të pandehur**. Duke krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me **vitin 2017**, ku janë gjykuar **1804 çështje penale në themel, me 2182 të pandehur**, numri i çështjeve ka një rritje prej 351 çështje .

Për sa i përket masave të sigurimit, në Gjykatën e Apelit janë gjykuar 958 **masa sigurimi personal**. Krahasuar me **vitin 2017**, ku janë **gjykuar 1396 masa sigurimi personal, ka një ulje të masave të gjykuara**.

Prokurorët i kanë kushtuar kujdes të veçantë studimit të çështjeve të themelit, për t'u përfaqësuar me cilësi në gjyq. Për sa i përket çështjeve të themelit, kanë ardhur dhe janë gjykuar mbi **apelin e prokurorit 637 çështje ose 29,6%** dhe, mbi **ankimin**

e të pandehurve 1518 çështje ose 70,4% të rasteve. Ndërsa, lidhur me masat e sigurimit në 958 raste, 100 raste kanë ardhur në Prokurorinë e Apelit mbi bazën e apelit të Prokurorit ose 10,4% dhe, në 858 raste kanë ardhur mbi ankimin e të pandehurve ose 89,6%.

Rëndësi të veçantë në punën e prokurorëve ka patur studimi i apeleve të prokurorëve. Kështu, **637 çështje** janë mbi apelin e prokurorit. Nga këto, nga prokurorët e apelit, nuk janë mbështetur 304 **apele ose 47,7%**. Nga këto, në 45 raste të ardhura mbi apelin e prokurorit është kërkuar pushimi i çështjes për shkak të ligjit mbi amnistinë. Këto çështje janë diskutuar me prokurorët që kanë përfaqësuar çështjen, si dhe me prokurorin e drejtorisë Gjyqësore në zbatim edhe të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi të drejtën e ushtrimit me efikasitet të ankimit.

Prokurorët kanë përkrahur apelet në shumicën e rasteve. Për çështje themeli, Gjykata e Apelit Tiranë, **nga 333 apele të përkrahura nga prokurori, ka pranuar apelet e prokurorit në 68 raste ose rreth 20,4%. Kjo përqindje, krahasuar me përqindjen e pranimin të apeleve në vitin 2017 (23,3%), është pak më e ulët.**

Në 1614 raste, nga prokurorët e Apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit **në 1459 raste ose 90,4%**. Nga 1943 çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi kërkesat e prokurorëve për lënie në fuqi dhe pranimin e apeli, janë pranuar konkluzionet e prokurorëve për 1527 çështje ose e shprehur në përqindje **78,6%**. Ka një rritje të vogël krahasuar me vitin 2017.

Gjatë vitit 2018 janë pushuar çështjet në 140 raste. Kjo për shkak të ligjit për amnistinë. Sipas rrethëve apelet janë të shpërndara si më poshtë:

- Tirana ka 506 apele, janë përkrahur nga prokurori 269 apele dhe është hequr dorë ose mospranuar apeli në 237 raste, ndërsa gjykata ka pranuar apele 52;
- Kruja ka 7 apele, janë hequr dorë nga apelet ose mospranuar apeli në 2 raste, janë përkrahur 5 apele nga prokurori. Gjykata e Apelit ka pranuar 1 apel;
- Kurbini ka 72 apele, është hequr dorë ose mospranuar apeli në 36 raste dhe janë përkrahur 36 raste, ndërsa Gjykata ka pranuar 8 apele;
- Dibra ka 28 apele, janë hequr dorë nga apeli ose mospranuar apeli në 16 raste, janë përkrahur 12 apele, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar 3 apele;
- Mati ka 24 apele, janë hequr dorë ose mospranuar apeli në 13 raste, janë përkrahur 11 apele dhe Gjykata ka pranuar vetëm 4 apele.

Nga pasqyra e këtyre treguesve, vihet re, se nuk janë përkrahur apelet për masa dënimi, ku diferenca ka qenë e vogël dhe, për vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore të veprës apo të personit nën hetim. Qëndrim i ashpër është mbajtur nga ana jonë për lirimin para kohe me kusht, pasi vetëm në 3 raste nuk kemi përkrahur apelin e prokurorit, pasi kemi konstatuar se gjykatat në këto raste, kanë aplikuar drejt kriteret ligjore për lirimin para kohe me kusht. Gjithsesi, lirimi para kohe me kusht mbetet problem, pasi deri më sot nuk ka praktikë të konsoliduar në asnjë vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, ku të përcaktohet qartë, se cilat do të konsiderohen arsye të veçanta për të aplikuar lirimin para kohe me kusht.

Në 1518 raste, çështja ka ardhur në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi bazën e ankimit të të pandehurit. **Në 13 raste ose 0,85 %** është kërkuar prishja e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është dërguar çështja për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë. Të njëjtën linjë ka mbajtur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, ku ka prishur dhe kthyer për rigjykim 13 çështje. Theksojmë, se në të gjitha këto çështje,

Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën tonë, pasi janë konstatuar shkelje të rënda procedurale në gjykimin në shkallë të parë.

Në 140 raste ose 6,5 % është kërkuar nga ana jonë pushimi i çështjes për efekt të amnistisë dhe, me të drejtë është pranuar nga Gjykata.

Për sa i përket çështjeve të themelit nga ana e prokurorit është kërkuar lehtësimi i pozitës së të pandehurit me 59 raste ose 2,7 %.

Për çështjet e themelit Prokurori ka kërkuar lehtësim pozite në 59 raste dhe pushim çështje në 140 raste. Tabela e mëposhtme shpreh për sa më lart, sipas prokurorëve:

Nr.	Prokurori	Lehtësuar pozita	Pushuar Çështja
1	Altin Dumani	11	13
2	Dritan Peka	2	10
3	Edi Hyka	2	25
4	Gentian Trenova	13	13
5	Genti Xholi	6	19
6	Luan Kaloçi	8	13
7	Nezir Gjoka	3	19
8	A.Qosja	8	18
9	F.Memçaj	6	10
	Total	59	140

Në 1614 raste, nga prokurorët e Apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit në **1459 ose raste ose 90.4%**, ka lehtësuar pozitën në **130 raste ose 8 %**, ka pushuar çështjen në **14 raste ose 0,9 %** dhe, ka kthyer për rigjykim **11 raste ose 0,7%**.

Nga këto tregues, vërehet, se janë prishur dhe kthyer për rigjykim 13 çështje, ku të gjitha janë raste të gjykimit në mungesë, i cili nisur nga vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, kërkon që në këto raste, bazuar në kriterin për një proces të rregullt ligjor, konstatohen shkelje procedural, për sa i përket njoftimit të të pandehurve dhe përfaqësimit të tyre në gjykim.

Është lehtësuar pozita e të pandehurit në 59 raste. Por, ka të bëjë kryesisht, me veprat penale të “drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, me ulje të vogla të masave të dënimit ose aplikimit brenda kriterëve ligjore të neneve 53 dhe 59 të K.Penal. Në të gjitha rastet kur është dhënë pafajësi ose janë pushuar akuzat, nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga ana jonë është kërkuar përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në disa çështje, por në masën më të madhe nuk është pranuar. Kjo, mbetet një prioritet në marrëdhënie me gjykatën, pasi do t’a bënte gjykimin në apel të plotë e objektiv dhe, do të ulte numrin e çështjeve, që prishen dhe kthehen nga Gjykata e Apelit për rigjykim.

Për sa i përket shpërndarjes së çështjeve sipas veprave penale, ato paraqiten si më poshtë vijon:

- Neni 137 i K.Penal, janë gjykuar 142 çështje me 144 të pandehur, me 5 të arrestuar;

- Neni 134 i K.Penal, janë gjykuar 135 çështje me 175 të pandehur, me 106 të arrestuar;
- Neni 278/2 i K.Penal, janë gjykuar 59 çështje me 75 të pandehur, 65 të arrestuar;
- Neni 279 i K.Penal , janë gjykuar 11 çështje me 11 të pandehur, 7 të arrestuar;
- Neni 283 i K.Penal, me 164 çështje, 226 të pandehur, 216 të arrestuar;
- Neni 284 i K.Penal , me 17 çështje, 24 të pandehur, 23 të arrestuar;
- Neni 290 i K.Penal, me 54 çështje, me 54 të pandehur, 24 të arrestuar.
- Neni 291 i K.Penal, me 162 çështje, me 168 të pandehur;
- Neni 186 i K.Penal, me 29 çështje, me 49 të pandehur, 2 të arrestuar;
- Neni 189 i K.Penal, me 15 çështje, me 16 të pandehur, 3 të arrestuar;
- Neni 143 i K.Penal, me 68 çështje, me 78 të pandehur, 27 të arrestuar;
- Neni 139 i K.Penal, 29 çështje, me 47 të pandehur, 44 të arrestuar;
- Neni 236 i K.Penal, 15 çështje, me 20 të pandehur, 2 të arrestuar;
- Neni 135 i K.Penal , 26 çështje, me 26 të pandehur, 6 të arrestuar;
- Neni 140 i K.Penal, 5 çështje, me 7 të pandehur, 7 të arrestuar.

Po kështu, vepra penale e vjedhjes, mbetet në vite me tregues të lartë dhe, vihet re gjithashtu, një rritje e numrit të veprave penale në fushën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe dhunës në famlje. Po kështu, mbetet me përhapje të gjerë vepra penale e përndjekjes, drejtimit të mjeteve në mënyrë të parregullt, vjedhja e energjisë elektrike, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor.

Persa i përket kundravajtjeve penale shpërndarja e çështjeve është si më poshtë.

Neni 84 i K.Penal, 13 çështje 14 te pandehur

Neni 89 i K.Penal 12 çështje me 21 te pandehur

Neni 90 i K.Penal 7 çeshtje me 11 te pandehur.
Neni 119 i K.Penal 3 çeshtje 3 te pandehur.
Neni 120 i K.Penal 6 çeshtje me 6 te pandehur
Neni 125 i K.Penal 3 çeshtje me 3 te pandehur
Neni 127 i K.Penal 1 çeshtje me 1 te pandehur.
Neni 149 i K.Penal 6 ceshtje me 6 te pandehur
Neni 242 i K.Penal 8 çeshtje me 10 te pandehur
Neni 273 i K.Penal 4 çeshtje me 4 te pandehur
Neni 274 i K.Penal 2 çeshtje me 2 te pandehur
Neni 275 i K.Penal 2 çeshtje me 2 te pandehur .
Neni 277 i K.Penal 12 çeshtje me 13 te pandehur

Në total 74 çështje kundravajtje penale, nga të cilat mbi apelin e prokurorit kanë ardhur 12 çështje. Nga ana e prokurorit është hequr dorë në 2 raste dhe është kërkuar pushimi i çështjes në 10 raste. Mbi bazën e ankimit të prokurorit kanë ardhur 62 raste dhe është kërkuar pushimi i çështjes në 42 raste. Është kërkuar mospranimi i ankimit në 6 raste dhe 13 raste është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Gjykata ka lehtësuar poziten në 3 raste, ka pushuar çështjen në 3 raste dhe ka lënë në fuqi vendimin në 7 raste. Ne 23 raste çështja ka ardhur mbi ankimin e të dëmtuarit.

Në 2 raste nga ana e Prokurorit është ushtruar apel kundërshtues.

Përsa i përket çështjeve të tjera janë gjykuar 630 çështje me 630 te pandehur, nga keto 145 çështje mbi apelin e prokurorit dhe 485 çështje mbi ankimin e të pandehurit. Nga ana e Prokurorit është hequr dorë nga apeli në 356 raste dhe është kërkuar pranimi i apelit në 110 raste. Nga keto Gjykata e Apelit Tirane ka pranuar apelin në 27 raste.

Nga numri i çështjeve në tërësi, Tirana zë numrin më të madh të çështjeve të gjykuara, 1749 çështje ose 81.1 %, më pas vjen Kurbini me 160 çështje ose 7,4 % të çështjeve, Kruja me 96 çështje ose 4,5%, Dibra me 94 çështje ose 4,4 % dhe Mat me 56 çështje ose 2,6 %.

Më poshtë, ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur ngarkesën e prokurorëve, si vijon:

Për çështje themeli

Nr.	Prokurori	Çeshtje	Apele	Apel te pand	Pr.Apeli	H.Dore	Pr.Apeli Gjkata	Rekurse
1	Dritan Peka	121	38	83	16	22	3	3
2	Edmond Hyka	327	91	236	39	52	6	10
3	Nezir Gjoka	308	90	218	48	42	5	16
4	Genti Xholi	269	79	190	36	43	12	7
5	Gentian Trenova	155	50	105	11	39	3	10
6	Fatjona Memçaj	231	64	167	48	16	7	17
7	Altin Dumani	272	76	196	50	26	16	19
8	Arben Qosja	262	76	186	55	21	10	31
9	Luan Kaloci	210	73	137	30	43	6	7

Total	2155	637	1518	333	304	68	120
-------	------	-----	------	-----	-----	----	-----

Përsa i përket masave të sigurimit, kanë ardhur mbi apelin e Prokurorit 100 raste ose 10,4 % të rasteve. Nga ana e prokurorëve është hequr dorë ose mospranuar apeli i prokurorit në 39 raste ose 39%.

Kryesisht, nuk kemi përkrahur apelin e prokurorit, për “Arrest në burg”, pasi i kemi konsideruar vendimet e gjykatave të shkallëve të para të drejta. Këto masa (234, 237 të K.Pr.Penale), janë aplikuar për të mitur, nxënës apo studentë, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët, për vepra penale, të cilat janë inicuar me ankimin e të dëmtuarve. Për sa i përket pranimit të apeleve, për masat e sigurimit për vitin 2018, Gjykata e Apelit, nga 61 apele të përkrahur nga prokurori, ka përkrahur 24 apele ose rreth 39,3% të apeleve.

Ndërsa, për masa sigurimi, apelet sipas rretheve janë si më poshtë vijon:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka 74 apele, janë hequr dorë nga apeli në 27 raste, janë pranuar 47 raste dhe Gjykata ka pranuar 20 raste ose 42,5 %;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka 6 apele, janë hequr dorë nga apeli në 4 raste, janë pranuar 2 apele, Gjykata ka pranuar 1 apel ose 50 %;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka 2 apele janë hequr dorë në 1 rast, është pranuar 1 apel, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka pranuar apelin;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka 14 apele, është kërkuar pranimi i 7 apeleve, është hequr dorë në 7 raste, gjykata ka pranuar 1 apel ose 14,3 %;

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ka 4 apele, është kërkuar pranimi i 4 apeleve, gjykata nuk ka pranuar 2 apele ose 50 %.

Për sa i përket masave të sigurimit, Tirana ka 787 çështje ose 82.2 % të çështjeve, Dibra 47 çështje ose 4,9%, Kurbini 55 çështje ose 5,7 %, Kruja 50 çështje ose 5,2 % dhe, Mati me 19 çështje ose 1,98%.

Nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë në 159 raste. Nga këto, **çështje themeli** 120 dhe **masa sigurimi** 39. Nga ky tregues, del qartë, se kemi rekursuar një numër të madh çështjesh, për mendimin tonë brenda kritereve ligjore. Megjithëse, nuk kemi të dhëna të plota për mënyrën e përfundimit.

Lidhur me masat e sigurimit, nga ana e prokurorëve është kërkuar miratimi i vendimit në 668 raste, nga ana e gjykatës është miratuar vendimi në 566 raste ose rreth 84,7% dhe, është ndryshuar vendimi në 101 raste ose 15,1 % dhe, në 1 rast është vendosur shfuqizimi i vendimit ose 0,1%.

Në 36 raste ose 3,8 %, nga ana e prokurorëve është kërkuar ndryshimi i masës së sigurimit, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata në përputhje dhe me Kodin e Procedurës Penale.

Në Gjykatën e Apelit, gjatë vitit të kaluar janë gjykuar 211 çështje me objekt shuarje masë sigurimi, ku në 190 raste, nga prokurori është kërkuar shuarja e masës së sigurimit, po kështu ka vendosur edhe gjykata. Në 20 raste për shuarje masë sigurimi, është kërkuar rrëzimi i kërkesës, për faktin, se i pandehuri nuk e kishte vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata dhe, në 1 rast është vendosur pushimi i gjykimit. Të njëjtën gjë ka vendosur edhe gjykata.

Shkaqet, për të cilat prokurorët kanë kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit në një masë sigurimi më të butë, kanë konsistuar në:

- kanë ndyshuar kushtet, rrethanat dhe kriteret ligjore të vendosjes së tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë, me kohën, kur kjo masë është gjykuar në Gjykatën e Apelit;
- faktit i është dhënë një kualifikim ligjor për një vepër penale më të lehtë se ajo që është arrestuar në fillim;
- është ndyshuar masa e sigurimit, nga arrest në burg, në masa sigurimi më të lehta për të miturit, që akuzohen për vepra penale të lehta (vjedhje në sasira tepër të vogla, përdorimi dhe mbatja në sasira të vogla të lëndëve narkotike të tipit canabis sativa, etj.), të cilat për nga sasia e vogël dhe rrethanat e çështjeve konkrete, krijohej bindja, se këto çështje shkonin drejt pushimit të çështjes;
- kanë ndryshuar kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, në kuptim të nenit 260 të K.Pr.Penale.

Nga ana e prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Tiranë është përballuar një volum i madh pune në studimin, përgatitjen e materialeve dhe përfaqësimin e çështjeve në gjyq për masa sigurimi. Siç u përmend edhe më lart, prokurorët në Prokurorinë e Apelit Tiranë janë përfaqësuar në gjykatë në 958 çështje për masa sigurimi personal e konkretisht:

Për masa sigurimi

Nr	Prokurori	Shuarje mase	masa	Total masa	Apele prok	Pr.Ape	H.Dore	Pranuar Gjykata	Nd. Masa	Rekurse
1	D.Peka	20	90	110	15	8	7	-	14	-

-2	A.Dumani	21	101	122	14	11	3	7	-	8
3	A.Qosja	20	100	120	15	10	5	2	1	17
4	E.Hyka	43	131	174	17	7	10	3	6	-
5	F.Memçaj	23	64	87	3	3		2	4	2
7	G.Xholi	26	112	138	15	12	3	6	3	7
8	N.Gjoka	25	63	88	11	5	6	2		1
9	G.Ternova	10	41	51	5	3	2	-	5	4
10	L.Kaloçi	23	45	68	5	2	3	2	3	-
	Total	211	747	958	100	61	39	24	36	39

Shpërndarja e çështjeve penale, sipas veprave penale për masa sigurimi është si më poshtë vijon:

- vepra penale e vjedhjes sipas nenit 134, me 54 çështje, me 70 të pandehur;
- neni 291, me 24 çështje, me 24 të pandehur;
- neni 278, me 36 çështje, me 38 të pandehur;
- neni 283, me 89 çështje, me 155 të pandehur;
- neni 248, me 11 çështje, me 35 të pandehur;
- neni 139, 11 çështje, me 11 të pandehur, neni 290, 32 çështje, me 4432 të pandehur;

- neni 236, me 9 çështje, me 9 të pandehur;
- neni 143, me 26 çështje, me 28 të pandehur;
- neni 130, me 143 çështje, me 150 të pandehur.

Gjithashtu, në vitin 2018 janë ekzekutuar 515 urdhëra ekzekutimi. Në zbatimin e urdhërave të ekzekutimit është mbajtur parasysh ekzekutimi i tyre në kohë sa më të shpejtë sipas ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale dhe urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Për vitin 2018, janë përgatitur dhe arshivuar të gjitha minidosjet e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, në të cilën ruhen akte të tilla, si: konkluzione të prokurorit të shkallës së parë, vendimi i gjykatës i shkallës së parë, ankimet e prokurorit ose të të pandehurit, konkluzionet e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, aktet e administruara, në rastet kur ka patur çelje të shqyrtimit gjyqësor dhe administrim të provave, si dhe rekursët e ushtruara.

Rezultatet e arritura deri tani në punën tonë janë fryt i rritjes së bashkëpunimit ligjor të vendosur me gjyqtarët penalistë të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kushtet e punës janë përmirësuar, pasi tani gjyqet zhvillohen me regjistrim audio, dosjet vijnë nga gjykata në kohën e duhur për t'u studiuar nga ana jonë, zhvillimi i gjykimit bëhet brenda etikës së seancës gjyqësore, rritja e transparencës së gjykimeve, duke hedhur në faqen e internetit të gjykatës listat e gjyqeve dhe vendimet, përmirësimi i kushteve të sallave të zhvillimit të gjyqeve në Gjykatën e Apelit.

Vizioni, synimet që kërkohen të arrihen dhe përmirësimet në punën tonë, për vitin 2019

Pavarësisht rezultateve dhe treguesve pozitivë, ku vlen të theksohet përkushtimi dhe profesionalizmi i prokurorëve, në drejtim të rritjes cilësore të punës, mbetet ende për t' u bërë. Nisur nga problematikat e hasura në praktikë, sugjeroj:

- të punohet më shumë për të përgatitur konkluzione të plota, të argumentuara ligjërisht, në zbatim të drejtë të ligjit material e procedural, duke dalë kur janë rastet, edhe përtej shkaqeve ligjore, që ngrejnë prokurorët e shkallës së parë në apelet e tyre;
- kur hetimi i kryer në shkallë të parë nuk është i plotë dhe, për pasojë nuk krijohet bindje e plotë për kualifikimet ligjore apo plotësim të provave të çështjeve që gjykohen në apel, të kërkohet përsëritje e shqyrtimit gjyqësor dhe plotësimi i hetimit gjyqësor, duke kërkuar prova të tjera shtesë gjatë gjykimit në apel;
- të vazhdohet të mbështeten apelet e prokurorëve për rëndim të pozitës së të pandehurit, për sa i përket masave të dënimit, kur diferenca, ndërmjet kërkesës së prokurorit dhe vendimit gjykatës së shkallës së parë është e dukshme dhe, për vepra penale me përhapje të gjerë të tilla, si: veprat penale në fushën e korrupsionit dhe veprimtarisë shtetërore, armëbajtje pa leje, krimet kundër jetës dhe shëndetit të shtetasve, krimet kundër pronës, mbajtja, përdorimi dhe tregtimi i lëndëve narkotike, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, etj.
- T'i kushtohet rëndësi e veçantë trajtimit të pandehurve, si dhe viktimave të mitur dhe zbatimi sa më rigoroz i Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Gjithashtu rëndësi e veçantë t'i jepet veprave penale në familje, kur viktimat janë femra, për shkak të shtimit të këtyre krimeve dhe pasojave të rënda shoqerore e sociale që sjellin.

- Nisur nga përvoja e punës si prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, në kuadër të unifikimit të praktikës, sidomos në lidhje me ndryshimet në kodin e procedurës penale, do të sygjeronin vijimin dhe intensifikimin e trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, për zbatim sa më të saktë të dispozitave të reja procedurale. Gjithashtu vlerësoj të dobishëm organizimin, nën kujdesin e Prokurorisë së Përgjithshme, të takimeve mes prokurorëve të apeleve, për evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve të zbatimit të ligjit procedural penal në praktikë.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj, se pavarësisht vështirësive dhe problematikave të hasura, ndryshimeve rrënjësore, kushtetuese dhe ligjore në sistemin e drejtësisë, sfida kryesore për të ardhmen, mbetet mobilizimi dhe përdorimi i të gjitha burimeve njerëzore e materiale, me efektivitet, përgjegjshmëri, transparencë dhe cilësi, përmirësimi i performancës dhe rritja e efikasitetit, duke shtuar numrin e çështjeve të fituara, për të bërë sadopak e kontribuar në kthimin e besimit të publikut në organet e drejtësisë.

Kjo, në drejtim edhe të përmbushjes së një prej kritereve të rëndësishme në procesin e integritetit në BE, atë të ndërtimit e konsolidimit të shtetit ligjor dhe të së drejtës.

Ju faleminderit!

DREJTUESI I PROKURORISË

Dritan PEKA